



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë, 05/03/2024

Në mbështetje të nenit 8, 10, dhe 15 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në shtojcën 1 pika 15 të Rregullores Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ligjin Nr. 08/L-260 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Planin e Punës së MZHR-së për vitin 2024, si dhe bazuar në Vendimin Nr. 477 dt. 17.08.2023 mbi Aproximin e Udhëzuesit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për realizimin e Programi për Zhvillim Rajonal PZHR 2024 dhe plotësim ndryshimin e Udhëzuesit për aplikim PZHR 2024 me Nr. 20 datë 18.01.2024, lidhet kjo:

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT
"Rregullimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësor, biçiklistë në parkun e Kamenicës-
Komuna e Drenasit, faza e dytë"

Palët Nënshkruese

1. Ministria e Zhvillimit Rajonal e përfaqësuar nga Ministri i MZHR-së (në tekstin e mëtejme MZHR) dhe,
2. Komuna e Drenasit e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna),

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit "Rregullimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësor, biçiklistë në parkun e Kamenicës-Komuna e Drenasit, faza e dytë" si dhe përcaktimi i obligimeve të MZHR -së dhe Komunës së Drenasit, për realizimin e këtij projekti.

Neni 2

Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit

1. Projekti “Rregullimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësor, biçiklistë në parkun e Kamenicës-Komuna e Drenasit, faza e dytë ” ka vlerën parallogaritare prej 217,869.25€.
2. MZHR nga buxheti i saj vjetor i vitit 2024, financon këtë projekt në shumën prej 120,00.00€.
3. Komuna e Drenasit nga buxheti i saj vjetor i vitit 2024, financon këtë projekt në shumën prej 97,869.25€.

Neni 3

Obligimet e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal

1. MZHR i zotën mjetet për projektin nga neni 2 paragrafi 2 i kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunë.
2. Pagesat për projektin “Rregullimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësor, biçiklistë në parkun e Kamenicës-Komuna e Drenasit, faza e dytë” bëhen në bazë të realizimit të punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës, gjithsesi deri në shpenzimin e mjeteve të zotuara të buxhetit të MZHR-së pagesat kryhen nga këto mjete e tek pastaj fillojnë pagesat e bashkëfinancim të projektit nga Komuna.
3. MZHR monitoron këtë projekt në të gjitha fazat. Monitorimi bëhet përmes zyrtarit i cili caktohet nga Departamenti për Zhvillim Rajonal ose nga OE që MZHR e kontraktin pa e përjashtuar edhe mundësinë e monitorimit të përbashkët (Zyrtar i MZHR-së – OE) dhe në rast se vërejnë parregullsi apo defekte gjatë realizimit të kontratës njoftojnë menaxhmentin.

Neni 4

Obligimet e Komunës

1. Komuna obligohet të sigurojë deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së parallogaritur të projektit dhe një kopje ta dërgojë në MZHR.
2. Komuna obligohet që projektin ta zhvillojë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 e Prokurimit Publik të Kosovës, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068,

Ligjin Nr. 05/1-092 si dhe në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, si dhe aktet nënligjore.

3. Komuna është bartëse e të gjitha procedurave të prokurimit sipas ligjit në fuqi. Procedurat e prokurimit, komuna duhet t'i filloj brenda 30 dite kalendarike pas marrjes së koonfirmimit për zotim të mjeteve nga MZHR në të kundërtën MZHR në mënyrë të një anshme mund të ndërpres marrëveshjen.
4. Komuna me rastin e formimit të Komisionit për procedurat e prokurimit dhe tenderimit duhet të kërkoj nga MZHR një anëtar të komisionit për vlerësimin e tenderëve.
5. Komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik të sjellë një kopje të kontratës identike me origjinalin në MZHR së bashku me informatat për biznesin me qëllim të sigurimit të nxjerrjes së urdhër blerjes (numrin e biznesit dhe numri i llogarisë bankare).
6. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe bën inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.
7. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagimin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.
8. Komuna obligohet që të njoftoj MZHR-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit, ndërsa për punime shtesë duhet të merret aprovim nga MZHR (për pjesën e financuar nga MZHR).
9. Komuna duhet të vendosë tabela informuese/Pano me dimensione 2m X 1.5m në vend punishte me përshkrimin si në vijim:
 - a) Emri i projektit,
 - b) Investitorët (Ministria e Zhvillimit Rajonal me logon e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komuna),
 - c) Emri i operatorit ekonomik dhe
 - d) Kohëzgjatja e punimeve sipas Kontratës së nënshkruar në mes të Komunës dhe OE.
10. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti të përfundoj gjatë vitit buxhetor 2024. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës.
11. Komuna është e obliguar të njoftoj MZHR -në për rrjedhat e realizimit të projektit sipas dinamikës së punimeve deri në përfundim të projektit.
12. Komuna obligohet që pas përfundimit të projektit, obligimeve kontraktuale të dërgoj në MZHR dokumentacionin përkatës me të cilin dëshmohet përmbyllja e projektit.

Neni 5

Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë nga Komuna

1. Për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera deri në shumën e financimit nga ana e MZHR -së, Komuna obligohet që të kompletoj dokumentacionin si në vijim:
 - 1.1 Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me Kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës;
 - 1.2 Vendimi për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimi nga ana e Komunës;
 - 1.3 Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimi mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet);
 - 1.4 Faturën origjinale nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar deri në shumën e financuar nga MZHR;
 - 1.5 Sigurimin e ekzekutimit, garanacionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës;
 - 1.6 Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).

Neni 6

Pronësia e projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kalojë në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 7

Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

1. Me propozim të Departamentit për Zhvillim Rajonal dhe me pëlqimin paraprak të Ministrisë të MZHR-së, dhe Kryetarit të Komunës marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. MZHR mbanë të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

3. Në rastet kur paraqiten konteste të çfardo natyre përgjegjësia mbetet mbi Komunën, rrjedhimisht MZHR mbanë të drejtën e ndërprerjes së kësaj Marrëveshje me automatizëm dhe mjetet e ndara për këtë projekt ti ridestinoj për projekte të tjera nga thirrja e këtij viti.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjes


Palët zgjedhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga Ministri i MZHR -së dhe Kryetari i Komunës.
2. Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy (2) kopje origjinale, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Fikrim Damka
Ministër i MZHR -së



Ramiz Lladrovci
Kryetar i Komunës Drenas

